

**Ambasadori Rohde:
Kosovën do ta mbaj
gjithmonë në zemër**



1 PAGE 3

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI NË DETYRË I KOSOVËS, ALBIN KURTI, PËRPIQET TA ZVOGËLOJË
PEZULLIMIN E DIALOGUT STRATEGJIK NGA SHBA-JA

KURTI: S'JEMI PRISHUR ME AMERIKËN, POR I KEMI DISA DALLIME



Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka folur për herë të parë për vendimin e ShBA-së për pezullimin e dialogut të planifikuar strategjik. Ai në mbledhjen e qeverisë ka thënë se nuk janë prishur

me Amerikën, por kanë disa dallime. Në këtë kontekst, Kurti i ka akuzuar "opozitarët" se po e stërmadhojnë këtë zhvillim negativisht, ndërsa ka thënë se është pezulluar planifikimi për

dialogun. "I siguroj qytetarët tanë se qeveria jonë i trajton seriozisht deklaratat dhe qëndrimet e Ambasadës së Amerikës", ka thënë Kurti

OPINION

**FILOZOFIA POLITIKE E UÇK-së
DHE RRËNIMI I MENTALITETIT
TË ROBIT** F.5

Ethem ÇEKU



OPINION



**FATOS KLOSI FTOHET TË
DËSHMOJË NË GJYKATËN
SPECIALE NË MBROJTJE
TË LIDERËVE TË UÇK-së** F.3

**KOSOVA VENDOS SANKSIONE TË
REJA KUNDËR RUSISË PËR SHKAK
TË LUFTËS NË UKRAINË** F.5

EKONOMI



**DURMISHI: QEVERIA
KA MIRATUAR 15 VENDIME PËR
PROJEKTE TË RËNDËSISHME
INFRASTRUKTURE** F.8

**AUV-i DHE ASK-ja
NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE
PËR SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE**

F.8

SPORT

**"VRAPIMI I NËNTORIT", NJË
VRAPIM QË BASHKON ME NGJYRAT
KUQ E ZI** F.10

**BETOHEN NË
PRESIDENCË
KRYEMINISTRI
DHE MINISTRAT
E KABINETIT TË RI
QEVERISËS TË
SHQIPËRISË** F.3



**SHBA-ja E
PËRDOR VETON
PËRSËRI KUNDËR
REZOLUTËS
SË OKB-SË PËR
ARMËPUSHIM
NË GAZA** F.7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja E PËRDOR VETON PËRSËRI KUNDËR REZOLUTËS SË OKB-së PËR ARMËPUSHIM NË GAZA

NJU-JORK, 19 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) e përdorën veton përsëri kundër një draftrezolute të Këshillit të Sigurimit të OKB-së e cila do të kishte kërkuar armëpushim të menjëhershëm, të pakushtëzuar dhe të përhershëm në Rripin e Gazës, si dhe do t'i kërkonte Izraelit t'i hiqte të gjitha kufizimet për dërgimin e ndihmave në enklavën palestineze. Teksti, i hartuar nga 10 anëtarët e zgjedhur të Këshillit me 15 vende, do të kishte kërkuar gjithashtu lirim të menjëhershëm, me dinjitet dhe pa kushte të të gjitha pengjeve të mbajtura nga Hamasi dhe grupe të tjera në Gazë. Zëvendësja e të dërguarit të posaçëm amerikan për Lindjen e Mesme, Morgan Ortagus, ka thënë se teksti nuk ishte i mjaftueshëm në dënimin e Hamasit dhe nuk e njihte të drejtën e Izraelit për vetëmbrojtje. Hamasi është i shpallur organizatë terroriste nga ShBA dhe Bashkimi Evropian. Draftrezoluta i ka marrë 14 vota për gjatë votimit të enjten vonë. Kjo është hera e gjashtë që ShBA-ja e përdor veton në Këshillin e Sigurimit lidhur me luftën pothuajse dyvjeçare në mes të Izraelit dhe militantëve

palestinezë të Hamasit. “Zia e bukës është e konfirmuar në Gaza - jo e parashikuar, jo e shpallur, por e konfirmuar. Ndërkohë, Izraeli ka zgjeruar operacionin ushtarak në qytetin e Gazës, duke thelluar edhe më shumë vuajtjet e civilëve. Për pasojë, e kemi këtë gjendje katastrofike, këtë dështim njerëzor dhe humanitar, që na detyroi të veprojmë sot”, ka thënë ambasadorja e Danimarkës në OKB, Christina Markus Lassen, para votimit. Qyteti i Gazës dhe zonat përreth po vuajnë zyrtarisht nga uria, e cila me gjasë do të përhapet, sipas një vëzhguesi botëror të urisë. Shtetet e Bashkuara tradicionalisht e mbrojnë aleatin e tyre, Izraelin, në Kombet e Bashkuara. Por, në një veprim të rrallë javën e kaluar, ato mbështetën një deklaratë të Këshillit të Sigurimit që dënonte sulmet e fundit në Katar, megjithëse teksti nuk përmendi se Izraeli ishte përgjegjës. Ky veprim ka pasqyruar pakënaqësinë e presidentit amerikan Donald Trump, me sulmin e urdhëruar nga kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu. Megjithatë, vetoja e së enjtes tregoi se vetëm një javë më vonë



Uashingtoni po i ofron sërish mbrojtje të fortë diplomatike Izraelit. “Hamasi është përgjegjës për nisjen dhe vazhdimin e kësaj lufte. Izraeli ka pranuar kushtet e propozuara që do ta përfundonin luftën, por Hamasi vazhdon t'i refuzojë ato. Kjo luftë mund të përfundojë sot nëse Hamasi i liron pengjet dhe heq dorë nga armët”, ka thënë diplomatja amerikane Morgan

Ortagus para votimit. Izraeli nuk ishte i kënaqur me deklaratën e Këshillit të Sigurimit për sulmet në Katar, ka thënë ambasadori i Izraelit në OKB, Danny Danon, për gazetarët, duke shtuar: “Por, mendoj se, në përgjithësi, niveli i bashkëpunimit me ShBA-në është aq i lartë, sa që jemi në rregull me këtë”. Danon ka thënë se, pas fjalimit që do ta mbajë në Asamblenë e

Përgjithshme të OKB-së javën e ardhshme, Netanyahu do të udhëtojë në Uashington për t'u takuar me Trumpin më 29 shtator. Netanyahu ka thënë më herët këtë muaj se ishte ftuar nga Trumpi për ta vizituar Shtëpinë e Bardhë. Këshilli i Sigurimit i OKB-së pritet gjithashtu të mbajë një takim të nivelit të lartë për Gazën të martën, pasi liderët botërorë do të jenë në Nju-Jork.

UKRAINA DISLOKON QINDRA ANTIDRONË KUNDËR SULMEVE RUSE



Kiev, 19 shtator - Ukraina planifikon të dislokojë së shpejti qindra antidronë si kundërpërgjigje ndaj sulmeve në shkallë të gjerë me dronë rusë, ka thënë ministri i Mbrojtjes, Denys Shmyhal. Në një konferencë për medie me homologun e tij polak, Wladyslaw Kosiniak-Kamysz,

Shmyhal ka thënë se “kur Rusia të lëshojë deri në 800 dronë brenda një nate të vetme, siç ka bërë më parë, Ukraina do të duhet të përgjigjet me jo më pak se 1 000 dronë interceptues”. Ai ka thënë se “Ukraina do ta arrijë këtë nivel”, por shtoi se “nuk mund të specifikojë se kur do të jetë në gjendje të

vendosë një numër të tillë”. Ai ka thënë se “sfida kryesore nuk qëndron në kapacitetin e prodhimit, por në kontrollin e antidronëve nga toka”. Forcat ruse kanë lëshuar vazhdimisht numër të madh dronësh kundër Ukrainës, ndonjëherë duke mbingarkuar sistemet e mbrojtjes ajrore të vendit.

BE-ja rrezikon të përballet me mungesë të ilaçeve thelbësore

BRUKSEL, 19 SHTATOR - Pacientët në Bashkimin Evropian pritet të vazhdojnë të përballen me mungesa të barnave esenciale. Kështu është thënë në një raport të publikuar nga Gjykata Evropiane e Auditorëve. Raporti ka theksuar se, me gjithë masat e ndërmarra deri më tani, rreziku për mungesë të disa ilaçeve, përfshirë antibiotikët më të zakonshëm, mbetet i lartë.

Gjatë periudhës janar 2022 - tetor 2024 shtetet anëtare të BE-së kanë raportuar mungesa të 136 barnave të ndryshme, duke arritur një rekord shqetësues në vitet 2023 dhe 2024. Klaus-Heiner Lehne, përfaqësues i Gjykatës Evropiane të Auditorëve, ka bërë thirrje për masa më të forta dhe të koordinuara për të adresuar këtë problem, duke theksuar varësinë e BE-së nga

tregjet aziatike për barna të përdorimit të gjerë, si paracetamoli dhe ibuprofeni. Ndërkohë, Komisioni Evropian ka pranuar nevojën për një kuadër më të fortë ligjor dhe ka shprehur optimizëm se propozimet e reja për legjislacionin që synon t'i luftojë mungesat do të miratohen së shpejti nga shtetet anëtare dhe Parlamenti Evropian.



Ambasadori Rohde: Kosovën do ta mbaj gjithmonë në zemër

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka shprehur mirënjohjen e thellë për pesë vitet e shërbimit në Kosovë, duke vlerësuar mbështetjen e marrë dhe lidhjet e forta të ndërtuara gjatë kësaj kohe. Ambasada e Gjermanisë në Kosovë ka njoftuar për ceremoninë lamtumirëse që është mbajtur ditën e

mërkurë, e ku prezente ishte edhe presidentja e vendit, Vjosa Osmani. “Megjithëse misioni zyrtar i ambasadorit Rohde përfundon javën e ardhshme, ai premtoi se do ta mbajë Kosovën gjithmonë në zemrën e tij dhe do të qëndrojë i lidhur me të”, është thënë në njoftimin e Ambasadës së Gjermanisë. Gjatë ngjarjes së lamtumirës ambasadori Rohde ka

shprehur falënderime të përzemërta. “Ai e cilësoi liberalizimin e vizave në vitin 2024 si një hap shpresëdhënës drejt lidhjeve më të ngushta me Evropën dhe lavdëroi marrëdhëniet e forta ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë, veçanërisht përmes diasporës frymëzuese kosovare - sipërmarrës, politikanë dhe artistë”, është thënë në këtë njoftim.



FATOS KLOSI FTOHET TË DËSHMOJË NË GJYKATËN SPECIALE NË MBROJTJE TË LIDERËVE TË UÇK-SË

Tiranë, 19 shtator - Ish-shefi i Shërbimit Informativ Kombëtar (ShIK), profesor Fatos Klosi, ka deklaruar se është ftuar dëshmitar në Gjykatën e Hagës për të dëshmuar në mbrojtje të liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Klosi në emisionin “Shqip” nga Dritan Hila në “Dritare TV” ka theksuar se shumë dëshmitarë nuk po akuzojnë drejtpërdrejt komandantët e UÇK-së dhe se mungesa e provave konkrete ka zgjatur procesin ndaj tyre. “Dëshmitarët që janë thirrur në Hagë nuk po përmendin emrat e ish-krerëve të UÇK-së, sepse nuk kanë qenë asgjëkund në skenë. Edhe nëse kanë bërë ndonjë hile, ose krim, nuk e



kanë bërë në sy të dëshmitarëve. Pra, ata nuk po i akuzojnë për gjëra konkrete,

por sepse kishin një ushtri dhe nuk ishin në gjendje ta kontrollonin. Ata nuk kanë

prova konkrete për komandantët. Ndaj po zgjatet tani procesi. Fakti që po i mbajnë në paraburgim për kaq shumë kohë duket sikur duan t'i shpallin fajtorë, por vështirë të ndodhë. Mua më ka kërkuar mbrojtja si dëshmitar në Hagë. Do të shkoj, por unë nuk kam qenë në Kosovë asokohe, sepse pjesa më e madhe e problemeve janë pasi kanë hyrë ushtritë aleatë në Kosovë, kur UÇK-ja nuk ishte më operative”, ka thënë Klosi. Profesor Klosi ka thënë se roli i komandantëve politikë të UÇK-së shpesh është duke u keqkuptuar pasi, sipas tij, ata nuk kanë vepruar drejtpërdrejt në terren, por kanë organizuar ushtrinë, gjë që ka vështirësuar

gjykimin dhe proceset gjyqësore. Më tutje, ai ka thënë se shumë nga akuzat ndaj udhëheqësve të UÇK-së në Gjykatën e Hagës janë të fabrikuara. “Hetimi u zhvillua me kohë të gjatë dhe kufijtë u tejkaluan në mënyrë të dukshme, gjithmonë me qëllim të nxjerrjes se sa më shumë dëshmitarëve. Natyrisht, shumë gjëra kanë ndodhur, por është e qartë që akuzat ishin shpesh të fabrikuara”, ka thënë Klosi. Deri më tani në mbrojtje të liderëve të UÇK-së kanë dëshmuar ish-zyrtari i lartë amerikan, James Rubin dhe ish-këshilltari ligjor i delegacionit të Kosovës në Rambuje, Paul Williams.



HARGREAVES VIZITON USHTARËT BRITANIKË NË ‘BONDSTEEL’: PRANIA E TYRE DEMONSTRON ANGAZHIMIN TONË PËR SIGURI NË KOSOVË DHE RAJON

Prishtinë, 19 shtator - Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, ka vizituar të premtën ushtarët britanikë që shërbejnë në Kosovë e që janë të vendosur në Kampin “Bondsteel”.

Hargreaves ka thënë se vendosja e tyre në Kosovë dëshmon aftësinë e ushtrisë britanike për ta përmbytur angazhimin në kuadër të NATO-s për siguri në Kosovë dhe Ballkan Perëndimor. “Vendosja e tyre dëshmon

aftësinë e Ushtrisë Britanike për ta përmbytur këtë angazhim të NATO-s dhe demonstron angazhimin e Mbretërisë së Bashkuar ndaj Kosovës dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor”, ka shkruar Hargreaves në “Facebook”.

Murati: Besojmë në pafajësinë e luftëtarëve të UÇK-së

Prishtinë, 19 shtator - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka folur sa i përket procesit të gjyimit në Hagë që po bëhet ndaj krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai ka thënë se besojnë në pafajësinë e luftëtarëve të UÇK-së. “Vetëvendosja ka qenë konsistente përgjatë gjithë kohës për sa i përket Gjykatës Speciale. Ne kemi kundërshtuar qysh në fillim një gjykatë që gjykon

monoetnikisht, pra vetëm një etni. Kemi qenë kundër që të bëhet një proces i tillë. Kjo është dëshmuar edhe gjatë procesit të votimit të asaj kohe. Kemi kundërshtuar, refuzuar dhe sot po e shohim që problemet që po sjellin. Nuk qëndron ajo që na ishte thënë atëherë, që do të bëhet vetëm një gjykim apo pastrim i imazhit të luftës çlirimtare. Ne shpresojmë, besojmë dhe urojmë në pafajësinë që gjykata, megjithatë, ta nxjerrë

verdictin e pafajësisë për të gjithë atë që po gjykohen atje dhe të kthehen këtu dhe pastaj janë çështje të tjera se çfarë ka ndodhur gjatë procesit të qeverisjeve. Mirëpo sa i përket Gjykatës Speciale, qysh e kemi thënë atëherë, e kemi të njëjtin qëndrim, që ka qenë dhe është gjykatë e padrejtë dhe ne besojmë në pafajësinë e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, ka deklaruar Murati në një konferencë për medie.





KRYEMINISTRI NË DETYRË I KOSOVËS, ALBIN KURTI, PËRPIQET TA ZVOGËLOJË PEZULLIMIN E DIALOGUT STRATEGJIK NGA SHBA-JA

KURTI: S'JEMI PRISHUR ME AMERIKËN, POR I KEMI DISA DALLIME

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka folur për herë të parë për vendimin e ShBA-së për pezullimin e dialogut të planifikuar strategjik. Ai në mbledhjen e qeverisë ka thënë se nuk janë prishur me Amerikën, por kanë disa dallime. Në këtë kontekst, Kurti i ka akuzuar “opozitarët” se po e stërmadhojnë këtë zhvillim negativisht, ndërsa ka thënë se është pezulluar planifikimi për dialogun. “I siguroj qytetarët tanë se qeveria jonë i trajton seriozisht deklaratat dhe qëndrimet e Ambasadës së Amerikës”, ka thënë Kurti

EPOKA E RE**Lirim GECI**

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka pranuar të premtën se qeveria e tij në detyrë ka “disa” dallime në qëndrime me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), por ka këmbëngulur se marrëdhëniet mes dy vendeve nuk janë prishur. Duke folur në një mbledhje të qeverisë në detyrë, Kurti ka thënë se dallimet mes tij dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës “shpesh kanë të bëjnë me qëndrimet tona në raport me Serbinë dhe veprimet ndaj strukturave ilegale të saj në Kosovë”.

Në këtë kontekst, Kurti i ka akuzuar “opozitarët” se po e stërmadhojnë këtë zhvillim negativisht, ndërsa ka thënë se është pezulluar planifikimi për dialogun. “Ndonëse opozitarët po e stërmadhojnë në dritë negative çdo ndodhi për raportet e qeverisë sonë me qeverinë amerikane, unë nuk dua t'i

minimizoj zhvillimet e fundit. I siguroj qytetarët tanë se qeveria jonë i trajton seriozisht deklaratat dhe qëndrimet e Ambasadës së Amerikës”, ka thënë Kurti.

Marrëdhëniet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë marrë një goditje javën e kaluar, kur kjo e fundit kishte arsyetuar vendimin se veprimet e qeverisë së udhëhequr nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, kanë “rritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë, duke kufizuar aftësinë e Shteteve të Bashkuara për të punuar në mënyrë produktive me Kosovën mbi prioritetet e përbashkëta”. “Shtetet e Bashkuara e kanë pezulluar për kohë të pacaktuar Dialogun e tyre të planifikuar Strategjik me Kosovën për shkak të shqetësimit rreth veprimeve të qeverisë në detyrë, të cilat i kanë rritur tensionet dhe jostabilitetin, duke e kufizuar aftësinë e Shteteve të Bashkuara për të punuar në mënyrë produktive

me Kosovën për prioritetet e përbashkëta”, ishte thënë në deklaratën e Ambasadës Amerikane.

Më tutje, Ambasada Amerikane kishte theksuar se mbetet e përkushtuar për avancimin e interesave të përbashkëta të ndara nga ShBA-ja dhe populli i Kosovës. “Ne mbetemi të përkushtuar ndaj avancimit të interesave të përbashkëta të ndara nga Shtetet e Bashkuara dhe populli i Kosovës”, ishte thënë në deklaratë.

ShBA-ja ka vlerësuar se veprimet dhe deklaratat e fundit nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, kanë paraqitur sfida ndaj përparimit të bërë ndër shumë vite. “Marrëdhënia jonë me Kosovën është e mbështetur në një qëllim të përbashkët: fuqizimi i paqes dhe stabilitetit si një bazë për mirëqenie të përbashkët ekonomike. Fatkeqësisht, veprimet dhe deklaratat e fundit nga kryeministri në detyrë Kurti kanë paraqitur sfida ndaj progresit të bërë ndër shumë vite. Dialogu strategjik kishte për

qëllim t'i fuqizonte lidhjet ekonomike dhe diplomatike për të mirën e popullit amerikan dhe kosovar. Ne shpresojmë që të ndjekim përpjekje të tilla në të ardhmen, kur të jetë e duhur. Ne e njohim këtë si qëllim i bërë prioritet nga populli i Kosovës”, është thënë në deklaratën e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Kosova dhe ShBA-ja pritej ta finalizonin dialogun strategjik këtë vit, pasi presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pati njoftuar në janar për arritjen e një marrëveshjeje mes dy vendeve për një dialog të tillë. Në lidhje me këtë vendim të ShBA-së, Kurti ka thënë se dëshiron të sqarojë se “bëhet fjalë për pezullim të dialogut të planifikuar strategjik, e jo të dialogut strategjik si proces të nisur”.

Kurti ka thënë se “nuk bëhet fjalë as për ndërprerje të komunikimit të rregullt që kemi”.

Nën Kurtin, autoritetet e Kosovës kanë nisur vitin e kaluar mbylljen e institucioneve paralele serbe në veri dhe jug të vendit, përkundër kritikave nga bashkësia ndërkombëtare, përfshirë ShBA-në.

Ndërsa javët e fundit u pezullua puna e Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe Fondit për Sigurim Invalidor e Pensional, që punojnë sipas sistemit të Serbisë në Mitrovicën e Veriut.

Kurti ka thënë se Kosova dhe

ShBA-ja vazhdojnë të kenë marrëdhënie të forta në dy shtylla, atë të mbrojtjes dhe të zhvillimit.

“Bashkëpunimi ushtarak po vijon, me ç'rast blerja e pajisjeve ushtarake dhe municioneve me administratën e tanishme po shkon edhe më mirë. Ndërsa në shtyllën e zhvillimit, qeveria jonë hoqi tarifën 10 për qind ndaj mallrave amerikane, administrata atje e vazhdoi programin e Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) për Republikën e Kosovës”, ka deklaruar Kurti.

Muajin e kaluar Kosova ka pranuar fluturake pa pilot “AeroVironment RQ-20 Puma”, të blera nga Shtetet e Bashkuara. Lidhur me vendimin për pezullimin e dialogut strategjik kishin reaguar ashpër përfaqësuesit e partive “opozitare” dhe shoqëria civile, duke e vlerësuar si goditjen më të rëndë për Kosovën në 26 vjet liri. Ata e kanë akuzuar Kurtin për veprime të papërgjegjshme në raport me shqetësimet e ShBA-së.

Çfarë është dialogu strategjik të cilin e pezulloi ShBA-ja?

Dialogu strategjik është një proces që Departamenti i Shtetit i ShBA-së në shumicën e rasteve ez hvillon me vende të ndryshme

KOSOVA VENDOS SANKSIONE TË REJA KUNDËR RUSISË PËR SHKAK TË LUFTËS NË UKRAINË

Prishtinë, 19 shtator - Kosova ka ndërmarrë masa ndëshkuese kundër Rusisë për shkak të luftës së saj kundër Ukrainës, duke i miratuar katër pakot me sanksionet e fundit të Bashkimit Evropian kundër Moskës. Në një mbledhje të premtën në mëngjes, qeveria në detyrë ka miratuar pakot 15, 16, 17 dhe 18 të sanksioneve të BE-së ndaj Rusisë.

“Miratimi i këtyre vendimeve nga ana e qeverisë do të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit të ngushtë me BE-në dhe partnerë të tjerë strategjikë, përfshirë Shtetet e Bashkuara”, ka thënë ministri i Brendshëm në detyrë, Xhelal Sveçla, gjatë prezantimit të kërkesës për miratim të masave. Sveçla e ka bërë kërkesën në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në mungesë të ministres në detyrë, Donika Gërvalla, e cili ndodhet jashtë vendit.

Të gjitha pakot janë miratuar njerëzi.

Çfarë përmbajnë pakot?

Pakojat e 15-të, e miratuar në dhjetor 2024, përfshinte ngrirje pasurish dhe ndalime udhëtimi për 54 individë dhe 30 entitete, si dhe kufizime të reja ndaj të ashtuquajturës anijes ruse në hije, me 52 anije të listuara, si dhe ndalime të eksportit për teknologji me përdorim të dyfishtë.

Ndërsa pakojat e 16, e miratuar në shkurt, në përvjetorin e dytë të agresionit rus në Ukrainë, shtoi 48 individë dhe 35 entitete në listën e zezë. Kjo pako ka ndaluar importin e aluminit nga Rusia dhe ka shenjëstruar edhe 74 anije të tjera, duke e çuar totalin në 153.

Masa shtesë prekën sektorin energjetik, transitin dhe shërbimet që ndihmojnë shmangien e sanksioneve, ndërsa sanksionet ndaj Bjellorusisë dhe territoreve të pushtuara u harmonizuan me ato ndaj Rusisë.

BE-ja ka miratuar paketën e 17 në maj, duke u fokusuar te kërcënimet hibride si, dezinformimi dhe sulmet kibernetike.

Janë vendosur kufizime për mediet shtetërore ruse në territorin e BE-së, janë shtuar

ndalesat për mallra dhe teknologji ushtarake, si dhe janë shënjestruar individë e kompani që ndihmonin Moskën t' shmangete sanksionet ekzistuese. Pakoja e 18 është miratuar në korrik dhe ajo përfshinë masa të forta ekonomike.

Me këtë pako është ulur çmimi i

kufirit për naftën bruto ruse nga 60 dollarë në 47.60 dollarë për fuçi, me rishikime çdo gjashtë muaj. BE-ja ka vendosur gjithashtu ndalime për transaksione që lidhen me tubacionet Nord Stream 1 dhe 2, ka bllokuar importet e produkteve të rafinuara nga

nafta ruse në vende të treta dhe zgjeroi listën e anijeve të flotës në hije. Paketës i janë shtuar masa të gjera financiare dhe ndalime të reja për eksportin e teknologjive strategjike. Kosova është rreshtuar përkrah Perëndimit menjëherë pasi Rusia e ka nisur pushtimin e

plotë Ukrainës në shkurt 2022, duke i vënë sanksione Moskës. Kjo luftë, e cila po vazhdon, sipas Kombeve të Bashkuara, ua ka marrë jetën mbi 10 mijë civilëve në Ukrainë. Të paktën 40 për qind e popullsisë kanë nevojë për një lloj të ndihmës humanitare.



të botës për synim avancimin e marrëdhënieve bilaterale. Ky proces përfshin diskutime të nivelit të lartë mes dy vendeve që zhvillohen ose në Uashington, ose në vendin përkatës, mbi një gamë të gjerë temash si mbrojtja, siguria, mjedisi, energjia, bashkëpunimi ekonomik etj.

ShBA-ja ka zhvilluar dialog strategjik vitet e fundit me Francën, Mbretërinë e Bashkuar, Rumaninë, Austrinë, Poloninë, Slloveninë, Moldavinë, Greqinë, Maqedoninë e Veriut, Katarin, Omanin, Bahrejin, Egjiptin etj. ShBA-ja përfshihet në dialog strategjik jo vetëm me shtete, por

edhe me organizata ose lëvizje të vendeve që ajo nuk i konsideron aleate, si Lëvizja Demokratike bjelloruse e udhëhequr nga Sviatlana Tsikhanouskaya.

Dialogu strategjik me Kosovën dhe Serbinë është përmendur gjithashtu në një deklaratë për shtyp të senatores amerikane Jeanne Shaheen në prill të vitit 2024. Në atë kohë Komiteti për Punë të Jashtme i Senatit të ShBA-së miratoi një projektligj të propozuar nga senatorja demokrate Shaheen dhe senatori republikan Roger Wicker, që synonte rritjen e angazhimit amerikan në Ballkanin

Perëndimor dhe u dërgua në Senat për shqyrtim.

Projektligji përmend gjithashtu nevojën për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se kur të jetë bërë përparim i mjaftueshëm, Shtetet e Bashkuara duhet t'i shqyrtojnë nismat për forcimin e marrëdhënieve bilaterale me të dyja vendet.

“Këta hapa të propozuar përfshijnë nisjen e dialogut strategjik dypalësh me Kosovën dhe Serbinë dhe mbështetjen e nismave konkrete në fushën e tregtisë dhe investimeve”, është

thënë në deklaratën për shtyp të senatores Jeanne Shaheen.

Në rajon, vetëm Maqedonia e Veriut ka hyrë në një dialog të tillë strategjik me ShBA-në. Takimi i parë u mbajt më 2 qershor 2022 në Uashington DC dhe u drejtua nga ish-ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, dhe ndihmëssekretarja amerikane e Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatike, Karen Donfried. Në atë kohë të dyja vendet kanë theksuar mbështetjen e tyre për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe riafirmuan angazhimin e tyre për integrimin rajonal të Ballkanit

Perëndimor përmes nismave politike, ekonomike dhe të sigurisë.

Në takim ata kanë nënvizuar rëndësinë strategjike të zhvillimit të aftësive të avancuara të mbrojtjes, zhvillimit të stërvitjeve dhe aktiviteteve të trajnimit dypalësh për ta përmirësuar ndërveprimin dhe gatishmërinë. Për më tepër, ata kanë riafirmuar angazhimin për rritjen e diversifikimit dhe pavarësisë energjetike në mbështetje të sigurisë kombëtare dhe ndan angazhimin për të zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar dypalësh.

FILOZOFIA POLITIKE E UÇK-SË DHE RRËNIMI I MENTALITETIT TË ROBIT



Ethem ÇEKU

Historia e kombit shqiptar është një udhëtim i gjatë dhe i mundimshëm nëpërmjet perandorive, pushtimeve dhe ideologjive shtypëse. Çdo etapë e saj është shënuar nga përpjekje për mbijetesë dhe nga përplasja për liri, ku gjenerata të tëra u ngritën mbi dhunën e historisë për të rikthyer dinjitetin e humbur. Në këtë rrugëtim, çdo hap drejt çlirim

është fituar me gjak, me qëndresën e rinisë dhe me sakrificat sublime të popullit. Pas vitit 1912, çështja shqiptare hyri në një fazë të re, ku përplasja ndërmjet aspiratës për bashkim kombëtar dhe iluzioneve të zgjidhjes brenda kornizave të pushtuesve e ndau elitën politike. Një pjesë kërkoi lirinë e plotë, ndërsa një pjesë tjetër mbeti e burgosur në logjikën e lëshimeve të pjesshme. Kjo mendësi e gjymtuar politike nuk mundi të japë përgjigjen e plotë për fatin historik të shqiptarëve. Në këtë vorbull u shfaqën misionet çlirimtare, të cilat në momente kyçe e çanë errësirën e robërisë dhe rrënuan mentalitetin e nënshtrimit. Siç shprehej Frantz Fanon: “Në çastin kur robi kupton se liria

është e vetmja rrugë drejt dinjitetit, ai nuk pranon më të jetojë i nënshtruar.” Kryengritjet e viteve 1910–1912, veprimtaria e Komitetit “Mbrotja Kombëtare e Kosovës”, kryengritja e Shaban Polluzhës më 1945 dhe demonstratat e 1968 e 1981, ishin hallkat që dëshmuar se shqiptari nuk mund të pajtohet me gjendjen e robit, sepse thellë në qenien e tij mbeti gjithmonë i gjallë etosi i lirisë. Kulmi i këtij procesi erdhi me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e cila artikuloi për herë të parë një filozofi politike të çlirim

kteu kombin nga filozofia e robit në filozofinë e çlirim. Ajo e bëri shqiptarët subjekt politik të historisë, aktorë të emancipimit kolektiv dhe bartës të një legjitimiteti moral universal, të njohur edhe nga bota demokratike. Me këtë akt historik, shqiptarët e Kosovës u vendosën në orbitën e qytetërimit perëndimor, duke rikthyer dinjitetin dhe duke e bërë njeriun shqiptar zot të tokës së vet. Në frymën e Hegelit, “liria është vetëdija e njeriut se ai është zot i fatit të vet” - dhe kjo vetëdije u mishërua në aktin e çlirim, i cili nuk ishte vetëm fitore ushtarake, por shndërrim paradigmantik i ekzistencës politike të shqiptarëve. Sot, shqiptarët jetojnë më afër se kurrë me idealin e lirisë dhe të barazisë. Dëshmitë e liderëve

botërorë mbi misionin e UÇK-së tregojnë se rruga drejt lirisë ishte e vështirë, por e drejtë, dhe se vetëm çlirimi i plotë dhe formimi i Republikës sonë ishte zgjedhja e qëndrueshme për Kosovën. Filozofia politike e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e finalizuar me aktin e UÇK-së, mbetet trashëgimi dhe udhërrëfyes për brezat e ardhshëm. Ajo është dëshmi se çlirimi nuk është vetëm një kategori politike, por mbi të gjitha një kategori morale dhe filozofike, që i kthen kombit dinjitetin dhe e fut në rrjedhën e pandalshme të qytetërimit perëndimor. Lavdi dëshmorëve të të gjitha kohëve! Nder dhe respekt për mbështetësit e çështjes shqiptare në të gjitha etapat e historisë.

Ç’KRAHASIM MUND TË JETË KY PRO-SHTETIT VS PRO-SHBA-SË?



Albinot MALOKU,
politolog

Së fundmi në diskursin publik në Kosovë, me apo pa vetëdije, po konturohet një linjë narrative që, në thelb, e vendos në kontrast përkushtimin ndaj shtetit dhe lidhjen e ngushtë me aleatët ndërkombëtarë, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo vijë diskursive, shpesh me tone populiste, përpiket të prezantojë një dallim artificial dhe thelbësisht të gabuar mes të qenit “pro-shtet” dhe “pro-ShBA-ve”. Në këtë kontekst, mbështetja për vendimet e qeverisë provohet të paraqitet si

një akt i “mospërkuljes” ndaj sugjerimeve të partnerëve. Ky konstrukt po provon të nxjerr aleancën e partneritetin strategjik si një lloj detyrimi që po e pengon pavarësinë e prosperitetin e vërtetë të Kosovës. Në termat e teorisë së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të shtet-ndërtimit, koncepti i sovranitetit nuk përjashton bashkëpunimin strategjik ndërkombëtar. Në kontekstin e shteteve të reja dhe në ndërtim, si Kosova, sovraniteti është shpesh funksional vetëm përmes ndërlidhjes me rrjete të qëndrueshme të aleancave. ShBA-ja, si aleati kryesor në procesin e çlirim, pavarësisë dhe konsolidimit institucional të Kosovës, nuk ka vepruar kurrë në kundërshtim me interesat themelore të saj. Ndaj, ndërtimi i një narrative që e vendos ShBA-në si pengesë për shtetndërtim është të paktën një keqinterpretim. Forcimi i shtetit të Kosovës nuk ndodh

përmes retorikës nacional-romantike apo konfrontimit të panevojshëm, por përmes respektimit të Kushtetutës, sundimit të ligjit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe politikave të mençura. Republika jonë në vend që të përballlet me sfidat e bollshme të saj përmes krijimit të një narracioni nacional-romantik po krijon një realitet alternativ ku çdo kritikë ose mospajtim perceptohet si kërcënim. Një tjetër tendencë shqetësuese që lidhet me këtë narrative është personalizimi i shtetit dhe institucionalizimi i liderit si përfaqësues i vetëm i interesit shtetëror. Kjo qasje është jashtëzakonisht e rrezikshme dhe thellësisht anti-demokratike. Historia politike botërore e ka dëshmuar se personalizimi i pushtetit është një shenjë paralajmëruese drejt autoritarizmit. Kur një lider politik portretizohet si mbrojtësi i vetëm i shtetit dhe interpreti ekskluziv i të vërtetës

politike, atëherë shteti fillon të identifikohet me personin dhe jo me institucionet. Kjo logjikë çon në devalvimin e sistemit të kontrollit dhe balancës së pushteteve, duke minuar vetë parimet themelore mbi të cilat ndërtohet një republikë demokratike. Në këtë kontekst, të pretendosh se “lideri është i gatshëm të flijojë gjithçka për shtetin” është më shumë një retorikë mikluere sesa një argument politik i shëndoshë. Për më tepër, është një justifikim i rrezikshëm që i hap rrugë kultit të individit dhe jo ndërtimit të një sistemi funksional institucional. Të argumentuarit se Kosova duhet të “mos kërkojë falje që po forcon shtetin e saj” është një populizëm i imtë që shfrytëzon ndjenjat kombëtare për të mbuluar sfidat reale politike e shtetërore. Askush e asnjëherë nuk i ka kërkuar Kosovës të kërkojë falje për vendosjen e rendit dhe ligjit, për fuqizimin e shtetit e të sistemit të vlerave

demokratike. Në një botë multipolare dhe gjithnjë e më të ndërlidhur, shtetet e vogla nuk e kanë luksin të operojnë në mënyrë të izoluar. Sovraniteti sot kuptohet më shumë si kapacitet për të marrë pjesë në vendimmarrje ndërkombëtare dhe për të qenë pjesë e rrjeteve globale të sigurisë, ekonomisë dhe diplomacisë. Në rastin e Kosovës, aleancat ndërkombëtare nuk janë vetëm një mjet për të rritur legjitimitetin ndërkombëtar, por parakusht për zhvillim politik, ekonomik e të sigurisë. Nëse ajo angazhohet të kufizojë ku duhet e ku nuk duhet aftësinë e bashkëpunimit me aleatët e saj, e ti jap përparësi glorifikimit e narratives për ta nxjerr individin si garantuesin e ekzistencës së shtetit mundësia për tu konsideruar krijes e deshtur është e madhe, e që kjo garanton devalvimin e gjitha angazhimeve historike për lirinë e demokracinë e vendit.

Betohen në Presidencë kryeministri dhe ministrat e kabinetit të ri qeverisë të Shqipërisë

Tiranë, 19 shtator - Ka përfunduar ceremonia e betimit të qeverisë së re në Shqipëri. Ndryshe nga tri ceremonitë e shkuara të betimit, kryeministri Edi Rama shkoi në presidencë me makinë. Atje e prisnin 15 ministrat, ndërsa Diellën, ministren digjitale, e kishte në celularin e tij Iphone në xhep. Si asnjë tjetër politikan në Shqipëri pas rënies së komunizmit, ky ishte momenti kur për herë të katërt Edi Rama betohet për ta qeverisur vendin, me prioritetin absolut “Shqipëri

2030 në BE”. E më pas një e nga një u betuan ministrat. Një trokitje gotash me urimet e presidentit Bajram Begaj drejt fotos së përbashkët në shkallët e presidencës. Duke respektuar semaforët Rama iu priu ministrave duke ecur në drejtim të kryeministrit, i qeshur e duke bashkëbiseduar me zëvendësen e tij Belinda Balluku në të djathtë, ndërsa ministrja me jetëgjatë e qeverisjeve socialiste Mirela Kumbaro i qëndronte në të majtë. Është një skenë e cila përsëritet

për të katërtën herë. Protagonisti i njëjtë. Edi Rama së bashku me ministrat e kabinetit të ri të katërt qeverisë sapo kanë përfunduar ceremoninë e betimit dhe po i drejtohen godinës të Këshillit të Ministrave për mbledhjen e parë të këtij kabineti të ri. Ecja e Ramës me ministrat tërhoqi vëmendjen e turistëve të cilët nxorën celularët duke filmuar këtë moment. Dhe në fund të kësaj ceremonie një foto në shkallët e kryeministrit duke shënuar zyrtarisht nisjen e



punës së qeverisë Rama 4 me plot sfida e peshën e madhe të një votëbesimi me 83 vota nga

shqiptarët ashtu siç edhe ua kërkoi Rama gjatë fushatës të 11 majit.

KURTI PËR INSTITUCIONET SHËNDETËSORE DHE ARSIMORE SERBE NË KOSOVË: DO TË PUNOJMË PËR T'I BASHKUAR NË NJË SISTEM TË VETËM



PRISHTINË, 19 SHTATOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, u ka dërguar mesazh serbëve të Kosovës duke thënë se ata meritojnë “qasje të barabartë në të mirat e përbashkëta” dhe se sistemi paralel i arsimit dhe shëndetësisë nuk është i qëndrueshëm. “Është e nevojshme përfshirja dhe bashkimi i tyre. Nuk dua ta bëj këtë kundër jush apo pa ju. Gjatë mandatit tonë të ardhshëm, së bashku me të gjithë ju, përfshirë edhe kryetarët e ardhshëm të komunave, do të punojmë për integrimin e shëndetësisë dhe arsimit në një dhe të vetmin sistem”, ka thënë Kurti në një videomesazh dërguar medieve. Kurti ka thënë se në kuadër të këtij procesi do t'i “bashkojmë përvojat dhe forcat me partnerët tanë ndërkombëtarë: Bashkimin Evropian dhe të dërguarin e tij të posaçëm për dialog, vendet e Quintit dhe KFOR-in”. “Shteti ynë garanton me Kushtetutë të drejtat dhe liritë për të gjithë ju dhe dëshiron bashkëpunim sa më të mirë për realizimin e tyre”, ka thënë ai.

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, që ka mbështetjen e Beogradit, reagoi ndaj deklaratave të Kurtit, duke theksuar se “kërcënimet për njëfarë integrimi të shëndetësisë dhe arsimit në sistemin kosovar nuk janë pjesë e asnjë negociate apo marrëveshjeje”. Siç është thënë në reagimin e Listës Serbe, shëndetësia dhe arsimi janë “shtyllat e mbijetesës së popullit serb dhe ashtu do të mbeten”. “Të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare flasin qartë se këto janë sisteme të ndara dhe kjo është ajo për të cilën do të luftojë Lista Serbe me mbështetjen e popullit serb. Megjithatë, ky është një kërcënim i qartë ndaj të cilit presim një reagim edhe më të fuqishëm nga bashkësia ndërkombëtare”, është thënë në reagim. Të gjitha institucionet shëndetësore në mjediset serbe në Kosovë funksionojnë në kuadër të sistemit të Serbisë. Përveç institucioneve arsimore, popullata lokale serbe dhe Beogradi zyrtar shpesh i përshkruajnë ato si jetike për mbijetesën e komunitetit serb në

Kosovë. Autoritetet e Kosovës javën e kaluar e pezulluan punën e Fondit për Sigurim Shëndetësor në Mitrovicën e Veriut, me arsyetimin se ky institucion nuk kishte dokumentacion të vlefshëm për ushtrimin e veprimtarisë. Njëkohësisht është pezulluar edhe puna e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

Çfarë do të thotë për popullsinë lokale pezullimi i fondeve të Serbisë në veri të Kosovës?

Këto vendime nxitën reagime nga Gjermania dhe Bashkimi Evropian, të cilët u bënë thirrje autoriteteve të Kosovës të përmbahen menjëherë nga “shënjestrimi” i institucioneve shëndetësore që funksionojnë në sistemin e Serbisë. Ato kanë kërkuar të mos ndërmerren hapa të njëanshëm, duke theksuar se është e domosdoshme konsultimi me komunitetin serb.

Pas zhvendës kryeministri në detyrë i Kosovës, Besnik Bislimi, mohoi se Prishtina zyrtare synon mbylljen e institucioneve shëndetësore, duke theksuar se inspektorët lokalë kishin ndërprerë “përkohësisht” punën e Fondit për Sigurim Shëndetësor. Ai e ka akuzuar Serbinë se po manipulon opinionin publik dhe po përhap lajme të rreme. Kurti të enjten mbrëma ka thënë se dallimet mes serbëve dhe shqiptarëve nuk janë shkak tensionesh, “por përmbytje e diversitetit që është pasuri e përbashkët dhe përparësi për zhvillim”. Ai është ndalur edhe tek arritjet e qeverisë së tij dhe të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, e cila udhëhiqet nga Nenad Rashiq. “Gjatë këtyre dy vjetëve e gjysmë nga emërimi i Nenad Rashiqit, në subvencionimin e qytetarëve nga komunitetet pakicë janë investuar gjithsej mbi 14 milionë euro”, ka thënë ai ndër të tjera. Kurti u ka bërë thirrje serbëve të mos u besojnë “thirrjeve luftënxitëse të zyrtarëve të lartë

nga Beogradi për kinse sulme ose pogrom që gjoja po përgatit Qeveria e Kosovës ndaj jush”. Për pezullimin e Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe Fondit për Sigurim Pensional e Invalidor ka reaguar i ashtuquajti drejtor i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, duke cilësuar atë si “goditje ndaj sistemit shëndetësor” dhe si pjesë të një fushate parazgjedhore për zgjedhjet lokale të cilat janë caktuar për 12 tetor. Po ashtu, ka reaguar edhe ministri i Jashtëm i Serbisë, Marko Gjuriq, duke thënë se mbyllja e Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe Fondit për Sigurim Pensional e Invalidor në Mitrovicën e Veriut është “akt i papranueshëm dhe çnjerëzor”. Fondi për Sigurim Shëndetësor, përkatësisht degët e Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Serbisë në mjediset serbe në Kosovë, ofrojnë shërbime jetike në fushën e shëndetësisë dhe kanë rol të rëndësishëm në funksionimin e vet sistemit shëndetësor, pasi sigurojnë financimin, organizojnë dhe garantojnë të drejtat e përdoruesve për mbrojtje shëndetësore.

Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor rregullon realizimin e të drejtave për pension në sistemin e Serbisë, përfshirë pensionin e pleqërisë, pensionin invalidor, pensionin familjar për anëtarët e familjes së të siguruarit të ndjerë. Gjithashtu, përmes këtij Fondi bëhet pagesa e pensioneve dhe evidentimi i stazhit të punës. Institucionet e Serbisë në Kosovë, autoritetet e Kosovës i konsiderojnë paralele dhe të jashtëligjshme, dhe mbyllja e tyre ka nisur në fillim të vitit 2024, gjë që ka hasur në kundërshtim të komunitetit serb, por edhe në kritika nga bashkësia ndërkombëtare. E ngarkuara me punë në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Anu Prattipati, më 4 shtator kishte deklaruar për një grup mediash që raportojnë në gjuhën serbe se të gjitha institucionet paralele të Serbisë, përfshirë ato arsimore dhe shëndetësore, duhet të integrohen në sistemin e Kosovës. Ajo kishte theksuar, megjithatë, se me rëndësi kyçe është mënyra se si do të bëhet kjo, pra integrimi duhet të zbatohet vetëm në konsultim me komunitetin serb.

Betohen 19 kadetët e rinj të Qendrës për Studime Universitare

Prishtinë, 19 shtator - Në kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë u mbajt ceremonia ushtarake e betimit të 19 kadetëve

të rinj të gjeneratës 2029. Gjenerata 2029 ka fituar me meritë vendin e saj në Akademinë Ushtarake, pasi ka

përballuar me sukses sfidat e “Javës 0” dhe muajit të rekrutit. Me guxim, disiplinë dhe këmbëngulje ata dëshmuar se

janë të gatshëm t'i shërbejnë atdheut. Me betimin solemn, ata nisin rrugëtimin e tyre të ri për t'u bërë udhëheqës të nesërme.



Kapitull i ri në tregtinë ShBA - Kosovë: Qytetarët mund të marrin mallra amerikane vetëm brenda një jave

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë ka bërë me dije se qytetarët e Kosovës mund të marrin mallra amerikane vetëm brenda një jave. Në njoftimin e Ambasadës Amerikane është se falë Paketos, klientët në Kosovë kanë

kanë qasje të drejtpërdrejtë në mbi një miliard produkte amerikane nga “Amazon”, “BestBuy”, “Walmart”, “Ebay”, etj. “Një kapitull i ri në tregtinë ShBA-Kosovë: Kosovarët mund të marrin mallra amerikane vetëm brenda një jave. Falë Paketos, klientët në Kosovë kanë qasje të drejtpërdrejtë në mbi 1

miliard produkte amerikane nga ‘Amazon’, ‘BestBuy’, ‘Walmart’, ‘Ebay’ dhe të tjera. Ky moment historik nxjerr në pah forcën e bashkëpunimit të sektorit privat ShBA-Kosovë në afrimin e tregjeve globale me familjet kosovare”, ka njoftuar Ambasada e ShBA-së në Kosovë.



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMPLETON SISTEMIN E ADRESAVE

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Dardan Fusha, mori pjesë si panelist në diskutimin e nivelit të lartë me temën “Mundësimi i së ardhmes: Si rregullatorët përmes transformimit digjital strategjik po hapin dhe integrojnë tregjet”, së bashku me përfaqësues nga Banka Kombëtare e Rumanisë dhe Autoriteti Kombëtar Rregullativ i Telekomunikimeve të Rumanisë. Paneli trajtoi mënyrën se si rregullatorët dhe vendimmarrësit po adresojnë mundësitë dhe sfidat e transformimit digjital në sektorin financiar. Në ndërhyrjen e tij, zëvendësguvernatori Fusha theksoi rëndësinë e reformave të vazhdueshme në sistemet e pagesave dhe infrastrukturën financiare të Kosovës, duke nënvizuar se transformimi digjital është në qendër të agjendës strategjike të BQK-së.

Ai veçoi miratimin e Ligjit të ri për Shërbimet e Pagesave dhe përgatitjen e kornizës ligjore për anëtarësim në SEPA përmes përafrimit të kuadrit të Kosovës me standardet e BE-së dhe zhvillimin e një sistemi të pagesave të shpejta në bashkëpunim me Bankën e Italisë dhe vendet e rajonit, i konceptuar për të ofruar pagesa më të shpejta, më të sigurta dhe më efikase në kosto për qytetarët dhe bizneset. Këta hapa strategjikë do t'i shkurtojnë kostot, do t'i lehtësojnë dërgesat nga jashtë dhe do ta thellojnë integrimin financiar të Kosovës me tregun evropian. Zëvendësguvernatori Fusha theksoi gjithashtu mundësitë afatgjata që sjellin financat digjitale për gjithëpërfshirjen financiare, veçanërisht për mundësimin e qasjes më të gjerë në shërbime të sigurta dhe të përbalueshme për grupet me qasje të kufizuar në sistemin financiar. Ai vuri në dukje se BQK-ja po përfiton nga përvojat e vendeve të



rajonit dhe tregjeve të avancuara të BE-së, duke i përshtatur zgjidhjet sipas kontekstit vendor të Kosovës. “Qëllimi ynë është të sigurojmë që inovacioni të zhvillohet brenda një kornize që garanton stabilitet, qëndrueshmëri dhe mbrojtje të konsumatorit”, theksoi

zëvendësguvernatori Fusha. Diskutimi nënvizoi, gjithashtu, rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve financiarë, të telekomunikimeve dhe të teknologjisë, si dhe sektorit privat, për ndërtimin e ekosistemeve të sigurta dhe inovative që mund ta mbështesin

rritjen edhe në periudha me paqëndrueshmëri më të lartë. Pjesëmarrja e BQK-së në këtë aktivitet riafirmon angazhimin e vazhdueshëm për modernizim, bashkëpunim rajonal dhe përafrim të infrastrukturës financiare të Kosovës me standardet evropiane.

DURMISHI: QEVERIA KA MIRATUAR 15 VENDIME PËR PROJEKTE TË RËNDËSISHME INFRASTRUKTURE



Prishtinë, 19 shtator - Ministri në detyrë i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, në një konferencë për medie, ka bërë me dije se janë marrë një numër i madh vendimesh që lidhen me projekte të rëndësishme për vendin. Ai ka thënë se janë miratuar gjithsej 15 vendime që prekin sektorët kyç,

konkretisht infrastrukturën rrugore dhe energjinë. “Sot kemi marrë shumë vendime që lidhen me projekte që lidhen me MMPHI, 15 vendime që lidhen me projekte shumë të rëndësishme. Është vendimi për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i

Projektit ‘Ndërtimi i Rrugës Korishë – Kabash – Lidhja me Rrugën Rajonale R118’”, ka thënë Durmishi. Po ashtu, ai ka njoftuar se është marrë vendim për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës së kompanisë KOSTT, që lidhet me shpronësimin dhe krijimin e të drejtës së servitutit për interesa publike.

AUV-i dhe ASK-ja nënshkruajnë marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Agjencia e Statistikave e Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet dy institucioneve. Me këtë marrëveshje AUV-i dhe ASK-ja obligohen që

shkëmbimin e të dhënave ta bëjnë në mënyrë të rregullt dhe të eliminohen procedurat burokratike të deritashme që vononin këtë proces. Gjatë takimit drejtori i AUV-së, Bekim Hoxha dhe drejtori i ASK-së, Avni Kastrati, diskutuan

edhe për krijimin e një sistemi më të integruar në të ardhmen, ku shkëmbimi i të dhënave të jetë një obligim institucional, pa pasur nevojën e marrëveshjeve të veçanta dhe të dhënat të shkëmbehet në kohë reale.



DONALD TRUMP PO BËHET MBRET I KRIPTOMONEDHAVE, POR ME ÇFARË ÇMIMI?



Presidenti i SHBA-së Donald Trump dhe familja e tij që prej kthimit të tij në Shtëpinë e Bardhë fitojnë miliarda me sipërmarrje krypto duke përfutur nga influenca e Trumpit në tregun me më pak rregulla. Meqënëse djemtë e Trumpit drejojnë sipërmarrjen, kritikët vërejnë një përzierje shqetësuese të pushtetit presidencial dhe përpjekjeve personale për përfitim.

Nga Meme-Coins deri tek Stablecoins – monedhat digjitale, që janë interpretuar në një vlerë fikse – fitimi financiar llogaritet të jetë mbi pesë miliardë dollarë (4,25 miliardë euro). Kritikët tërheqin vëmendjen për lakminë e pashembullt për fitim të presidentit në post. Dy sipërmarrje i nxisin fitimet krypto të familjes Trump: World Liberty Financial (WLF), një platformë financiare e decentralizuar, rregullat e kredidhënies së të cilës mund të bashkëkonceptohen nga përdoruesit me tokenin \$WLFI, dhe American Bitcoin Corp. (ABTC), një sipërmarrje Bitcoin për kërkimin e pasurive nëntokësore e regjistruar në Nasdaq.

WLF me shtijen e \$WLFI-Token, që janë të lidhura me emrin e Trumpit, fiton miliona, ndërsa ABTC, që mbështetet në djemtë e tij, posedon vlera të rëndësishme pasurie Bitcoin. Me hedhjen në bursë kursi përkohësisht u rrit me rreth 110 përqind, duke u fiksuar me 16,5 përqind mbi kursin fillestar të inagurimit që ishte 6,90 dollarë.

Sipas një informacioni të agjencisë së lajmeve Reuters, sipërmarrja e Trumpit posedon 60 përqind të WLF dhe pretendon 75 përqind të të ardhurave nga shitja e Coins-ave.

Ushtrim shqetësues influence

Kritikët mendojnë, se presidenti republikan me rolin e dyfishtë si përfitues nga kriptomonedhat dhe vendimmarrës politik po minon besimin në opinionin publik duke i përzier kufijtë mes drejtimit të qeverisë dhe pasurimit vetiak.

Juristi dhe eksperti i financave në SHBA, Ross Delston, tërheq vëmendjen, se krypto-firmat mund t'u ofrojnë një shteg investitorëve të dyshimtë, që përmes Coins-ave digjital të sigurojnë influencën politike tek Trump.

"Kjo është një rrugë e re që i mundëson presidentit, të marrë para prej kujt, përfshi edhe persona dhe shtete, që sipas ligjeve të SHBA-së për luftën elektorale do të ishin të ndaluara, ose nga persona, që janë dënua për vepra penale ose ndaj të cilëve zhvillohen hetime", thotë Delston për DW.

Trump zbut rregullat për kriptomonedhat

Gjatë mandatit të tij të parë Trump e cilësonte monedhën digjitale Bitcoin si "mashtim" dhe kërcënim për dollarin. Tani ai do ta kthejë SHBA-në në

kryeqendrën krypto të botës.

Nën Trumpin promovuesi prej shumë vitesh i kriptos Paul Atkins u bë drejtues i Autoritetit të SHBA-së për Mbikqyrjen Financiare SEC. Një ndër dekretet e para të nënshkuara nga Trump në janar ishte t'u ndalojë të gjitha autoriteteve të SHBA-së krijimin ose nxitjen e një banke qendrore të monedhës digjitale (CBDC) – një versioni krypto i dollarit i dhënë nga qeveria.

Në mars ai filloi të krijojë një rezervë strategjike krypto me konfiskimin e pasurive krypto. Në verë Trump nënshkroi genius act, kuadri i parë ligjor federal për Stablecoins.

Bankete madhështore dhe favore politike

Entuziazmi për kriptomonedhat është përhapur përtej politikës në evente të nivele të larta shoqërore, veçanërisht për darka e bankete për depozituesit e mëdhenj digjital, organizuar nga Shtëpia e Bardhë. Takimet ekskluzive me meny të pasura dhe akses ekskluziv tek presidenti po kritikohen për shkak të përzierjes së pushtetit politik me interesat financiare private.

Një ngjarje e spikatur ishte Crypto Kings-Dinner në maj 2025 në klubin kombëtar të golfit Trump në Virxhinia, ku ishin ftuar nga Meme-Coin \$TRUMP e Trumpit investitorë, që bashkarisht kishin investuar 148 milionë dollarë.

Në event 25 investitorëve të

mëdhenj të Meme-Coin \$TRUMP të Trumpit iu krijua akses privat tek presidenti, ndërsa katër bashkëaksionerëve më të mëdhenj iu dhuruan orët luksoze nga koleksioni i Trumpit. Justin Sun, një krypto-miliarder i lindur në Kinë dhe këshilltar i World Liberty Financial, ishte me shpenzimet në vlerën e 18,5 milionë dollarëve i ftuari më i rëndësishëm.

"Me gjasë kjo është një tjetër përpjekje e qeverisë, të ndërlidhë postet publike me inetrat private", deklaroi për DW Richard Briffault, profesor në Columbia Law School.

Autoritetet rregulatore të rezervuara, ndërsa kritikët bëjnë thirrje të merren masa

Autoritetet rregulatore në SHBA qendrojnë të tërhequra sa i përket mbikqyrjes së kriptomonedhave. Së fundi Uashingtoni ka shfuqizuar disa rregulla. Si p.sh. deklarimin e vlerave të pasurive krypto në bilancet e firmave. Në këtë mënyrë sipërmarrjet kanë më shumë hapësirë veprimi, për t'i avancuar bizneset e tyre. Ndërsa mbikqyrja e bursës SEC nën drejtorin e mëparshëm Gary Gensler iu kundërvu me hetime të rrepta dhe akuza kësaj dege, masat nën qeverinë e dytë të Trump janë lënë krejt pasdore. Si "kapitalizëm krypto me stimulus" e përshkruan një nga rrethi i brendshëm i Trump këtë zhvillim. Kjo degë është në bum,

por sa i përket temave të etikës, transparencës dhe stabilitetit afatgjatë vëzhguesit kanë ngrënë shumë pikëpyetje.

Përmasa alarmante të shkarkimeve në autoritetet federale

Gjithnjë e më shumë kryeartikuj po u kushtohen shkarkimeve të nëpunësve federalë, që qeveria Trump i ka halë në sy, si guvernatorja e Bankës së Rezervave Lisa Cook, drejtorja e Autoritetit të Shëndetësisë në SHBA, CDC, Susan Monarez apo shefja e Autoritetit të Statistikave të Tregut të Punës, Erika McEntarfer.

"Qeveria nuk ka skrupuj për të shkarkuar njerëzit, ndër ta edhe nëpunës të thjeshtë, nëse ata nuk janë politikisht në të njëjtën linjë me qeverinë", thotë juristi i Columbias Richard Briffault. "Nuk ka sinjal më të qartë se sa shkakrimi i drejtores së Bureau of Labor Statistics (Erika McEntarfer, d. Red.). Nëse ata janë të gatshëm, janë të gatshëm të shkarkojnë këdo."

Klima e karakterizuar nga frika dhe hakmarrja ka si pasojë, që autoritetet e mbikqyrjes nuk i shqyrtojnë me sy kritik projektet krypto të Trumpit – madje as edhe kur janë evidente problemet etike. Në kongres po shtohen thirrjet për një kontroll më të rreptë. Deputetët kërkojnë rregulla të qarta për monedhën digjitale, më shumë transparencë për sipërmarrjet si WLF dhe kushte për nëpunësit me rezerva të vetat krypto. DW



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Faqja zyrtare e Bayernit me fjalë të mëdha për Fisnik Asllanin

BAYERN, 19 SHTATOR - Bayern Muncheni ka analizuar kundërshtarin e radhës, skuadrën e Hoffenheimit, aty ku luajnë rregullisht dyshja e Kosovës, Fisnik Asllani dhe Leon Avdullahu.

Kampioni i Gjermanisë do të përballet sot (e shtunë) me Hoffenheimin në kundër të javës së javës së katërt në

Bundesligën gjermane. Duke analizuar kundërshtarin dhe pikat e forta, nuk ka se si të mos përmendej sulmuesi i Kosovës, Fisnik Asllani, i cili është një nga faktorët që skuadra pas tri javëve ka gjashtë pikë dhe shtatë gola të shënuar. Tri gola dhe një asistim janë veprat e 23-vjeçarit që është sensacion i

javëve të para në Gjermani. Bayerni e përmend rikthimin e futbollistit të Hoffenheimit duke pasur një sezon të shkëlqyer në ligën e dytë, me 19 gola për Elversberg. Skuadra është në tranzicion duke transferuar dhjetë lojtarë të rinj, në mesin e të cilëve edhe Leon Avdullahu

nga Baseli. “Asllani luan si një nëntëshe e gjysmë, anis sulme, krijon hapësira dhe di të gjuajë mirë, diçka ngjashëm si Harry Kane, por ende jo në nivelin e tij”, ka shkruar faqja e Bayernit për yllin e Kosovës, që po gëzon momente të mira në Bundesligë, por edhe të kombëtarja dardane.



PRESIDENTI ADEMI: ARBËRI MBETET NJË ASET I ÇMUAR PËR KOSOVËN

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka takuar futbollistin e Kombëtares së Kosovës, Arbër Zenelin. Ai ka thënë se me Arbërin ka biseduar për “karrierën e tij, rikuperimin pas lëndimit, kthimin në nivelin elitare, por edhe evokuam kujtime nga ndeshjet dhe paraqitjet e tij të paharrueshme me ekipin kombëtar”.

Ademi ka thënë se Arbër Zeneli mbetet një aset i çmuar për Kosovën. “Sot pata kënaqësinë

të takoj një futbollist të jashtëzakonshëm dhe një djalë fantastik, anëtarin e ekipit tonë kombëtar, Arbër Zenelin. Me Arbërin folëm për karrierën e tij, rikuperimin pas lëndimit, kthimin në nivelin elitare, por edhe evokuam kujtime nga ndeshjet dhe paraqitjet e tij të paharrueshme me ekipin kombëtar, me shpresën se së shpejti do të jetë sërish pjesë e kombëtares sonë. Arbëri mbetet një aset i çmuar për Kosovën”, ka shkruar Ademi në “Facebook”.



NORA GJAKOVA NIS KARRIERËN SI TRAJNERE, DEBUTON NË KUPËN EVROPIANE PËR SENIORË

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Pas Majlinda Kelmendit, e cila ka nisur suksesshëm karrierën si trajnere e xhudos, një tjetër medaliste olimpike, Nora Gjakova, do ta nis karrierën si trajnere.

Nora Gjakova, e cila e fitoi medaljen e artë Olimpikë në Tokyo 2020, pas shumë trofeve e medaljeve evropiane e botërore, më 20 shtator do të debutojë si trajnere, në Kupën Evropiane për Seniorë, në Shkup. “Më 20-21 shtator 2025, në Shkup do të mbahet Kupa Evropiane për Senior ku pritet pjesëmarrja e rreth 300 garuesve nga 30 shtete. Kosovën do ta përfaqësojnë:

XHIRO 5			
	MALISHEVA		PRISHTINA
	FERIZAJ		GJILANI
	DRENICA		DUKAGJINI
	LLAPI		BALLKANI
	DRITA		PRISHTINA E RE

Dardan Cena (-73kg), Anes Veseli (-90kg) dhe Shpati Zekaj (-100kg). Dardan Cena garon nesër me 20 shtator, ndërsa Anes Veseli dhe Shpati

Zekaj garojnë me 21 shtator. Ekipi është i shoqëruar nga trajnerja Nora Gjakova, ka shkruar Federata e Xhudos e Kosovës, në “Facebook”.

“VRAPIMI I NËNTORIT”, NJË VRAPIM QË BASHKON NËN NGJYRAT KUQ E ZI

PRISHTINË, 19 SHTATOR - “Vrapimi i Nëntorit”, si një nga format më autentike të shënimit të Ditës së Flamurit tonë Kombëtar, ditëlindjes së komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, ditës së daljes së parë publike të UÇK-së si dhe nderimit të të gjithë të rënëve për liri dhe pavarësi, do të

mbahet edhe këtë 28 Nëntor në Prekaz. Ky është edicioni i 5 i këtij eventi, tashmë tradicional ndërsa, sipas organizatorit, regjistrimi tashmë është hapur për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të garojnë në këtë vrapim. Vrapimi do të bëhet në dy disiplina: 11 km, KUQ, dhe 28 km, ZI.



Dy milionë euro më shumë, i rritet vlera Mirlind Dakut para sfidës me Serbinë

Prishtinë, 19 shtator - Mirlind Daku tashmë vlen 10 milionë euro, sipas “Transfermarkt”. Deri ditën e djeshme vlera e sulmuesit të Kombëtares

shqiptare ka qenë 8 milionë euro, por tashmë ajo është rritur. Plot 2 milionë euro më shumë vlen sulmuesi nga Gjilani, i cili po kalon një

moment të mirë me Rubin Kazanin në Rusi. Ky vlerësim vjen pak para ndeshjes që Shqipëria do të luajë përballë Serbisë.

Këtë sezon Daku ka luajtur në 11 ndeshje me Rubin Kazan. Në këto sfida që ka marrë pjesë ia ka dalë të shënojë 8 gola dhe të asistojë në një tjetër.





Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Micom-M Plus” SH.P.K. me seli në Leposaviç, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810699655 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Micom-M Plus” D.O.O. Leposavic donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810699655 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Micom-M Plus” L.L.C. with headquarters Leposaviç, has come to the decision to quit its business: 810699655 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qëndrim Hoxha shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të shm mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- “Zivinarska Farma Pilke” shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 811814848.
- Liridona Maxhunaj shpall të pavlefshme dëftesat e shfmu “Selman Riza” Gjakovë.
- Marigona Bahtiri shpall te pavlefshme diplomën me nr. 71 drejtimi Inxhinieri Ekonomike – Master Fakulteti “Isa Boletini” arsyeya ndërrim mbiemri.
- Ismet Tahiraj shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu “Zekiria Rexha” Gjakovë nga kl. 1-8.
- Llabinot Murati shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shmle “Hasan Prishtina.
- Behar Hyseni shpall të pavlefshme diplomën e shm mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sabit Beqiri shpall te pavlefshme diplomën e shmle “Hasan Prishtina”.
- Rozvita Deda shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë drejtimi Farmaci.
- Sanije Ibrahim shpall te pavlefshme diplomën e shmlt “Arkitekt Sinani” ish shkolla “Boris Kidric”.
- Berneta Boshnuaku shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Rinor Xhemajli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Fazli Alija shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu “Dëshmorët e Dushkajes” Bardhaniq Gjakovë nga kl. 1-8.
- Edin Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “28 Nëntori” Brodosan.
- Mërgim Alija shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu “Dëshmorët e Dushkajes” Bardhaniq Gjakovë nga kl. 1-8.
- “Burim Toast” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811919466 Prishtinë.
- Adriatik Kokalla shpall të pavlefshme dëftesat e kl 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

